



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"  
REKTORATI

Nr. 1159 Prot.

Gjirokastrë, më 20.09.2023

**Lënda:** Hapet thirrja për pjesëmarrje në Programin Erasmus+ në IES Ribeira Do Louro

Në kuadër të Programit Erasmus+, IES Ribeira Do Louro hap thirrjen për shkëmbim studentësh me Universitetin e Gjirokastrës.

Sipas Marrëveshjes Ndër-Institucionale, Universiteti i Gjirokastrës do të marrë pjesë me **4 pozicione** për studentë për mësimnxënie (Bachelor), dhe **8 pozicione** për studentë për praktikë mësimore (Bachelor ose Master) për një periudhë tre-mujore. Thirrja është e hapur për studentët e Fakultetit Ekonomik (Njësia bazë Kontabilitet-Financë dhe Njësia bazë Administrim Publik), viti i II ose i III. Gjuha e përdorur do të jetë anglisht B2 ose spanjisht B2.

Të interesuarit të dërgojnë pranë Sektorit të Marrëdhënieve me Jashtë dhe Kërkimit Shkencor, brenda datës **27.10.2023**, në formë fizike dhe elektronike:

- vërtetim studentit;
- letër Interesi në anglisht;
- CV të detajuar mundësisht në formatin EUROPASS CV në anglisht;
- provë / çertifikatë të njohurive të gjuhës angleze ose spanjolle në nivelin B2;
- fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit.

Dokumentacioni juaj do të vlerësohet paraprakisht nga një komision AD HOC i ngritur pranë UGJ dhe më pas Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë dhe Kërkimit Shkencor do të përcjellë nominimet, në IES Ribeira do Louro për vlerësimin përfundimtar të aplikantëve të cilët do të përzgjidhen.

**Shënim:** Aplikantët do të paraqiten për intervistë pranë Sektorit të Marrëdhënieve me Jashtë dhe Kërkimit Shkencor për të provuar njohuritë e tyre të gjuhës angleze.

Prof. dr. Bektash Menga

REKTOR

